



Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

Raportet financiare të fushatës dhe Raporti i Auditorëve të pavarur

**Zgjedhjet Lokale
03 Tetor 2013 deri me 01 Dhjetor 2013**

Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur..	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	7
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	8
Shënimet e pasqyrave financiare.....	9-13

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Opinion i Kualifikuar

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “AAK”), të përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 1 Dhjetor 2013, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve me 03 Tetor 2013 deri me 1 Dhjetor 2013, dhe informacionet tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin të kualifikuar të raportit tonë, Pasqyrat Financiare të bashkëngjitura paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit Politik me datën 1 Dhjetor 2013, dhe të Hyrat dhe Shpenzimet për periudhën 03 Tetor 2013 deri me 1 Dhjetor 2013, në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-174, Për financimin e subjekteve politike dhe me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058.

Bazat për Opinion të kualifikuar

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në Përgjegjësitë e Auditorit në paragrafin për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe ne kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë.

- Subjekti Politik ka pranuar donacione në të holla përmes arkës në shumë totale prej 114,400.00 euro gjatë fushatës 2013 me çka ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 4 të ligjit Nr 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr 03/L-174 për financimin e partive politike ,të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr 04/L-058, i cili e lejon që pranimi i mjeteve të bëhet vetëm përmes llogarisë bankare. Për me tepër Subjekti Politik ka pranuar donacione në të holla në vlerë mbi 2,000.00 Euro brenda vitit nga persona fizik në kundërshtim me këtë ligj.
- Ashtu siç prezantohet në Shënim 7 të pasqyrave financiare të bashkëngjitur, Subjekti Politik ka deklaruar shpenzime në vlerë 252,917.00 Euro për periudhën 3 Tetor 2013 deri me 1 Dhjetor 2013. Në mungesë të dokumentacionit mbështetës në

nuk kemi mundur te verifikojmë saktësinë e shpenzimeve te raportuara në vlerë 100,944.50 Euro.

- SP gjatë vitit 2013 ka operuar me një (1) llogari kryesor bankare dhe me 27 nënlllogari në kuadër të Raiffesisen Bankës në kundërshtim me kërkesat ligjore te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 neni 3 pika 3, c cili lejon subjektet politike te kenë një llogari te vetme bankare.

Theksim i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik ka pranuar donacione ne vlere mbi 1,000.00 EUR nga i njëjti person brenda një dite ne kundërshtim me kërkesat ligjore Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit te terrorizmit, neni 26 Detyrimet shtesë të partive politike.
- Subjekti politik nuk ka shpalosur shënimet mbi pagesat e kryera në vlerë mbi 5,000.00 Euro një marrësi te vetëm brenda ditës ashtu siç parashihet ne ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.
- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet te mirëfilltë për ti mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas Standardeve të Kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik nuk e ka te definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet ne ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore ne lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe te fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre te ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-256 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-073 Për Zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Përgjegjësia e menagjmenti dhe atyre që janë të ngarkuar me qeverisje për pasqyrat financiare.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë



auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Fadil Hyseni
Auditor Ligjor
5 Dhjetor 2017

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Bilanci në fundë	Bilanci në fillim
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet			
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata		0.00	0.00
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme			
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	2	376.53	9,247.43
Pasuritë tjera afatshkurtra		-	-
Total pasuritë afatshkurtra		376.53	9,247.43
Total pasuritë		376.53	9,247.43
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		9,247	9,247.43
Suficiti / (deficiti) i vitit		(133,517)	
Total Ekuiteti		(124,270)	9,247.43
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyera			
Gjithsej detyrimet agatgjata		0	0.00
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera	3	88,646	
Huatë e pagueshme			
Detyrimet tjera afatshkurtra	4	36,000	
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		124,646	-
Gjithsej detyrimet		124,646	-
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		376.53	9,247.43

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

	Shënimi	Për periudhën 03.10.2013- 01.12.2013
Të hyrat		
Të hyrat nga buxheti		
Të hyrat nga anëtarësia		
Donacionet dhe kontributet në të holla	5	114,400.00
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime	6	5,000.00
Te hyrat e liruar nga te hyrat e shtyera		
Të hyrat tjera		
Gjithsej të hyrat për periudhën		119,400.00
Shpenzimet		
Pagat dhe kompensimet	7	99,640.00
Shpenzimet e transportit	7	3,257.02
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	7	108,019.98
Blerja e mallrave	7	41,000.00
Shpenzimet e përgjithshme	7	1,000.00
Shpenzimet e ndryshme	7	
Gjithsej shpenzimet për periudhën		252,917.00
Suficiti (deficiti) për periudhën		(133,517.00)

1. Informata te përgjithshme

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës është partia e tretë më e madhe në Kosovë.

Udhëheqja: Ramush Haradinaj (Kryetar i partisë)

Themelues: Ramush Haradinaj

Themeluar: në vitin 2000

Pasqyrat financiare te Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Bazuar në nenin 19 paragrafi 2 pika 7 e Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 ,Subjekti i regjistruar politik brenda pesë (5) ditëve të punës nga marrja e draft raporteve të audituara ka dorëzuar raportin e rishikuar financiar dhe shpjegimet lidhur me gabimet ose lëshimet të identifikuara nga auditorët.

Subjekti Politik mirëmban vetëm një llogari te vetme bankare ne bankën RBKO.

Subjekti Politik i ka 36 degë në territorin e Republikës së Kosovë.

Subjekti Politik nuk ka një bazë te shënimeve mbi numrin e anëtareve të saj.

Shënimi 2. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

	Bilanci ne funde Shuma në Euro	Bilanci ne fillim Shuma në Euro
Paraja në bankë	376.53	9,247.43
Paraja në arkë	-	-
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	376.53	9,247.43

Shënimi 3. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera

	Bilanci ne funde Shuma në Euro	Bilanci ne fillim Shuma në Euro
Almiri AS	15,000.00	
TV 21	5,942.00	
Klan Kosova	5,428.00	
RTK	3,300.00	
Llogari te pagueshme te tjera	58,616.00	
Gjithsej Llogarite e pagueshme dhe te tjera	88,286.00	0.00

Shënimi 4. Detyrimet tjera afatshkurtra

	Bilanci ne funde Shuma në Euro	Bilanci ne fillim Shuma në Euro
Detyrimet për paga dhe tatime		
Detyrimet për qira		
Detyrimet për gjoba dhe ndëshkime	36,000.00	
Detyrimet tjera afatshkurtra		
Gjithsej detyrimet tjera afatshkurtra	36,000.00	0.00

Shënimi 5: Donacionet dhe kontributet në të holla

Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera ne Euro	E pranuar përmes	
Kontribuesi	Adresa	Numri Personal			Banke	Arke
Blerim Devolli	Peje			10,000.00		10,000.00
Ramiz Kelmendi	Peje			10,000.00		10,000.00
Shkelqim Devolli	Peje			10,000.00		10,000.00
Ekrem Lluka	Peje			10,000.00		10,000.00
Hysen Gecaj	Rahovec			10,000.00		10,000.00
Shyqri Shala	Rahovec			10,000.00		10,000.00
Shkelzen Jusaj	Prishtinë			10,000.00		10,000.00
Musa Islamaj	Prishtinë			6,000.00		6,000.00
Halil Gashi	Prishtinë			5,000.00		5,000.00
Besir Bytyqi	Prizeren			5,000.00		5,000.00
Agim Nitaj	Prishtinë			5,000.00		5,000.00
Agim Elshani	Peje			5,000.00		5,000.00
Gezim Salihu	Prishtinë			3,000.00		3,000.00
Veton Hamzaj	Prishtinë			2,000.00		2,000.00
Arber Islamaj	Prishtinë			2,000.00		2,000.00
Bujar Morina	Drenas			2,000.00		2,000.00
Ardian Gjini				1,500.00		1,500.00
Time Kadriaj				1,500.00		1,500.00
Burim Ramadani				1,500.00		1,500.00
Ahmet isufi	Prishtinë			1,500.00		1,500.00
Daut Haradinaj				1,500.00		1,500.00
Fatos Mani				1,000.00		1,000.00

Gent Begolli			900.00		900.00
Gjithsej donacionet dhe kontributet ne te holla :			114,400.00	0.00	114,400.00

Shënimi 6: Kontributet ne natyre ne mall dhe shërbime

Përshkrimi i mallit / shërbimit	Pranuar nga			Data kur është dhënë kontributi	Vlera ne Euro
	Kontribuesi	Adresa	Numri Personal		
Hapsire reklamuse	Selmans Network	Prishtinë	600766325		5,000.00
Gjithsej kontributi ne natyre ne mall dhe shërbime :					5,000.00

Shënimi 7: Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompenzimet			
Pagat dhe kompenzimet, neto	99,640.00	99,640.00	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit			0.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit			0.00
Tatimet në të ardhura personale			0.00
Beneficionet tjera			0.00

Gjithsej	99,640.00	99,640.00	0.00
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara	2,300.00	2,300.00	0.00
Karburantet	957.02	957.02	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.			0.00
Sigurimi dhe mirëmbatja e veturave			0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit			0.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	3,257.02	3,257.02	0.00
Reklammat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali	36,856.00	21,856.00	15,000.00
Ushqimi	0.00	0.00	-
Aktivitete kulturore dhe rekreative	0.00	0.00	-
Radio dhe spotet televizive	55,997.00	32,806.98	23,190.02
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta	10,465.00	4,450.00	6,015.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	4,701.98	3,000.00	1,701.98
Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	108,019.98	24,733.98	83,286.00
Blerja e mallrave			

Furnizimi i zyrës			0.00
Pajisjet të vogla			0.00
Gjithsej blerja e mallrave	0.00	0.00	0.00
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës			0.00
Telefoni, interneti dhe posta			0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)			0.00
Gjobat dhe ndëshkimet	36,000.00		36,000.00
Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet ne natyrë në mallra dhe shërbime	5,000.00	-	-
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	41,000.00	-	36,000.00
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës			0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	1,000.00	1,000.00	0.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	1,000.00	1,000.00	0.00
Gjithsej shpenzimet			
	252,917.00	128,631.00	124,286.00